



Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosovo

ZYRA RREGULLATORE PËR UJËSJELLËS DHE KANALIZIM
REGULATORNI URED ZAVODU I KANALIZACIJE
WATER AND WASTEWATER REGULATORY OFFICE



ZRRUK/UTSH/USH – 07/05-07/2015
30 Dhjetor 2014

Në pajtim me autoritetin e dhënë me *Ligjin Nr. 03/L-086, Mbi Veprimtaritë e Ofruesve të Shërbimeve të Ujësjetillësi dhe Kanalizimit*, datë 13 Qershor 2008 me të cilën është amendamentuar Rregullorja e UNMIK-ut 2004/49 ("Ligji")

Konform Nenit 15 të Rregullës për Përcaktimin e Tarifave të Shërbimeve të Ujësjetillësit, Kanalizimit dhe të Furnizimit të Ujit me Shumicë në Kosovë, datë 24 dhjetor 2012 (Rregulla - ZRRUK R 02/U&K),

Duke u bazuar në Urdhëresën Tarifore të Shërbimeve të Ujit me pakicë për shërbimet e ofruara në regjionin e zonës Jugore të Qytetit të; Mitrovicës, Vushtrrisë dhe Skenderajt (ZRRUK-UTSH-07/05/2014) e cila ka konfirmuar vazhdimin e vlefshmërisë së tarifave të vitit 2014 edhe gjatë vitit 2015 edhe tarifës së ujit të trajtuar me shumicë të vitit 2014 i vazhdohet vlefshmëria e saj për tu aplikuar edhe gjatë vitit 2015 për shërbimin e furnizimit të ujit me shumicë të trajtuar të Pjesës Veriore të Qytetit të Mitrovicës nga KRU "Mitrovica" sh. a. Mitrovicë,

Zyra Rregullatore për Ujësjetillës dhe Kanalizim ("ZRRUK") lëshon këtë:

URDHËRESË TARIFORE SHËRBIMI

PËR TARIFËN E UJIT TË TRAJTUAR ME SHUMICË QË DUHET TË APLIKOHET NGA
KRU "MITROVICA" SH. A. MITROVICË, PËR FURNIZIM TË PJESËS VERIORE TË QYTETIT TË MITROVICËS
GJATË VITIT TARIFORË 2015 NGA PROCESI RREGULLATORË I TARIFAVE TË VITEVE 2015-2017

1. Interpretimi

Në këtë Urdhëresë Tarifore të Shërbimit, përveç nëse konteksti e kërkon ndryshe, fjalët dhe shprehjet me shkronja të mëdha do të kenë kuptimin që iu atribuohen Rregullës ZRRUK - R 02/U&K.

2. Zbatueshmëria

Urdhëresë e Tarifës së Shërbimit ZRRUK/UTSH/USH – 07/05-07/2015 është e zbatueshme dhe e detyrueshme për aplikim nga KRU "MITROVICA" Sh. A. Mitrovicë, të cilës i kërkohet të aplikoj tarifën e shërbimit sipas kësaj Urdhërese Tarifore të Shërbimit me rastin e faturimit të Ujit me Shumicë të Trajtuar për Pjesën Veriore të Qytetit të Mitrovicës.

3. Lista e Tarifave të Shërbimit

Gjatë vitit tariforë 2015 të periudhës së procesit rregullatorë 2015 - 2017, KRU "MITROVICA" Sh. A., Mitrovicë, do të furnizojë pjesën Veriore të Qytetit të Mitrovicës me ujë të trajtuar me shumicë me tarifën e vitit 2015 të pasqyruar në tabelën e më poshtme, kolona 5.

Tabela 1. **Tarifa e procesit rregullatorë për aplikim gjatë vitit 2015,**
nga procesi rregullatorë 2015-2017

Numër Rendor	Përshkrimi i shërbimit me ujë	Njësia matëse	Tarifa historike e vitit 2014	Tarifa e aplikueshme për faturim gjatë vitit 2015
1	2	3	4	5
1	Ujë me shumicë i trajtuar	€/m3	0.17	0.17

Tarifa e aplikuar është pa TVSH.

4. Aplikimi i tarifës

Tarifa e Shërbimit për furnizim të ujit me shumicë të trajtuar e aprovuar sipas kësaj Urdhërese Tarifore të Shërbimit do të aplikohet;

Nga: **1 janari 2015 gjer me 31 dhjetor 2015.**

ZRRUK, konkludon vazhdimin e aplikimit të tarifës së ujit të trajtuar me shumicë të vitit 2014 edhe gjatë vitit 2015, pasi edhe tarifat e furnizimit të ujit me pakicë për Pjesën Jugore të Regjionit të Mitrovicës kanë mbet të pa ndryshuara për vitin 2015. Tarifa e ujit me shumicë të trajtuar është e ndërlidhur me tarifat e ujit me pakicë, prandaj, konsiderojmë se nuk ka ndonjë arsye për ta korrigjuar të njëjtën tani për tani.

Tarifa e këtij shërbimi do të rishikohet për korrigjim dhe përshtatje të saj me rastin e korrigjimit dhe rishikimit të tarifave të ujit me pakicë të cilat janë pasqyruar në dokumentet e këtij shërbimi për Regjionin e Pjesës Jugore të Qytetit të Mitrovicës.

5. Publikimi dhe Shpërndarja e Listës së Tarifës së Shërbimit

KRU "MITROVICA" Sh. A., Mitrovicë është e obliguar të njoftojë marrësin e Shërbimit të Ujit të Trajtuar me Shumicë, me tarifën e aprovuara sipas kësaj Urdhërese Tarifore të Shërbimit dhe të bëjë nënshkrimin e Kontratës për këtë shërbim me te dhe së paku një herë me faturën e parë të ngarkesës tarifore sipas kësaj UTSH-je ti bashkëngjis të njëjtën faturës me të cilën informohet marrësi i shërbimeve.

6. Apelet


KRU "Mitrovica" sh. a. ka të drejtë të apelojë në afatin kohorë prej 15 ditëve të punës në rast mospajtimi me këtë UTSH-ë, tek Komisioni për Shqyrtim që themelohet konform nenit 34. Komisioni shqyrtues, pika 34.1., Ligji Nr. 03/L-086 mbi Veprimtaritë e Ofruesve të Shërbimeve të Ujës-jellës dhe Kanalizimit, të datës 15 qershor 2008.

7. Gjuha Zyrtare e Urdhëresës së Tarifave

Urdhëresë e Tarifave ZRRUK/UTSH/USH – 07/05-07/2015, nxjerrët dhe publikohet në dy (2) versione të shkruara në gjuhët zyrtare që përdoren në Kosovë, dhe atë në:

- 1) Gjuhen Shqip, dhe
- 2) Gjuhen Serbe, dhe eventualisht në
- 3) Gjuhen Angleze.

Në rast të mospërputhjeve në mes të versioneve, do të mbizotërojë versioni i Gjuhës Shqipe.


.....
Raif Preteni, Drejtor i ZRRUK-ut